

VENDIM
Nr. 508, datë 1.8.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT, ME OBJEKT “PROJEKTZBATIMI PËR NDËRTIMIN E SHËTITORES SË PLAZHIT TË DURRËSIT, NGA URA E DAJLANIT DERI NË GODINËN E KONVALESHENCËS”, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, me objekt “Projektzbatimi për ndërtimin e shëtitorës së plazhit të Durrësit, nga Ura e Dajlanit deri në godinën e Konvaleshencës”, Bashkia Durrës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 26 298 893.60 (njëzet e gjashtë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 26 298 893.60 (njëzet e gjashtë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë) lekësh, përballohet nga Bashkia Durrës.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Durrës.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Durrës.

8. Bashkia Durrës kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Durrës.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Durrës për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Durrës për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONA PRIVATE E TË CILËVE PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, ME OBJEKT “PROJEKTTZBATIMI PËR NDËRTIMIN E SHËTTTORES SË PLAZHIT TË DURRËSIT, NGA URA E DAJLANIT DERI NË GODINËN E KONVALESHENCËS”, BASHKIA DURRËS

Nr. rendor	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE SIPAS KARTELËS SË PASURISË								VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM			Shënime
	Emër	Atësia	Mbiemër	ZK	Nr. i pas	Lloji i pas.	Sip. tot.	Truall	Ndërtesa	Volum	Faqe	Sip. e shpronësimit (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	
1	Mereme		Kila	8518	4/50	Truall	727	727	0	68	156	34.6	19,336.00	669,025.60	Konfirmuar nga ASHK-ja Nr. dok. 17091. Mbi këtë truall është regjistruar një pallat me nr. pasurie 4/50- nd. v. 82 f. 12. Sqarim. Objekti nuk preket nga shpronësimi.
2	Dilaver		Mezini	8518	4/49	Truall	73	73	0	68	157	12.2	19,336.00	235,899.20	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Gezim	Zija	Hoxha	8518	8/110	Truall	500	500	0	13	98	138.2	19,336.00	2,672,235.20	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Dashuri	Zija	Hoxha												
	Zenel	Hasan	Korbi												
	Reshit	Hasan	Korbi												
	Rahim	Hasan	Korbi												
	Behixhe	Hasan	Fortuzi												
	Shpresa	Hasan	Raxhimi												
4	Zaralanda	Skrat	Kopali	8518	10/32	Truall	120	0	0	26	89	108.6	19,336.00	2,099,889.60	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Landi	Sotir	Rexha	8518	10/33	Truall	480	480	0	26	90	352.8	19,336.00	6,821,740.80	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Pulie	Sotir	Ciku												
	Mitrush	Sotir	Rexha												
	Andrea	Sotir	Rexha												
	Dafina	Sotir	Rexha												
	Kristaq	Sotir	Rexha												
	Lefka	Sotir	Cekani												
	Loreta	Gole	Puleshi												
6	Naim	Sadri	Kapiti	8518	27/112	Truall	400	400	94	17	248	195	19,336.00	3,770,520.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Godinë soc-ekonomike 1-k. Sqarim. Objekti nuk preket nga shpronësimi.
7	Abdulla		Dervishi	8518	27/106	Truall	400	400		16	244	280.4	19,336.00	5,421,814.40	Konfirmuar nga ASHK-ja Me vendim nr. 1 të gjendjes civile nr. 2 Durrës, ka ndryshuar emri nga Dylbere në Vera Nuredini. Nr. dok 12697, datë 19.3.2010. Seksioni E: kufizimet e pronësisë: me kontrate sipërmarrjeje nr. 4105/1178, datë 3.11.2009. Kjo pronë vihet në favor të firmës “Novaj 2001” sh.p.k. ref. 12697. Nr. dok. 15127, datë 30.9.2011. Në bazë të deklaratës not. nr. 1508/721, datë 29.9.2011 revokohet kontrata e sipërmarrjes. nr. dok. 25935, datë 3.12.2015, në
	Nuriye		Seferi												
	Feride		Kraja												
	Muharrem		Dervishi												
	Vera		Nuredini												
	Sovjet		Keçi												
	Aferdita		Keçi												
	Agron		Keçi												
	Diamada		Dervishi												
	Dhurata		Kamedani												
	Fatbardh		Dervishi												
	Servete		Gjyzeli												
Shqipe		Sula													
Mimoza		Islamaj													

	Fiqiri		Dervishi												bazë të dekl. not. nr. 4157/1688/1, datë 24.11.2015 revokohet kontrata e sipërmarrjes në favor të “Qazim Invest” sh.p.k. Sqarim. sipas shkresës nr. 349/13 prot., datë 19.6.2024 të Bashkisë Durrës, ndryshimi i emrit të bashkëpronares nga Dylbere në Vera Nuredini është bërë sipas vendimit nr. 1, datë 18.12.2002, të gjendjes civile.
8	Rexhep Emanuela	Mehmet Fatmir	Mehmeti Mehmeti	8518	27/317	Truall	200	200	0	130	71	108.3	19,336.00	2,094,088.80	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	Ermal	Rifat	Kapllani	8518	27/357	Truall	148	148		142	99	130	19,336.00	2,513,680.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
														26,298,893.60	